



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

TREGUESIT STATISTIKORË TË SHËRBIMEVE POSTARE

Tremujori I 2019



Përmbajtje

I . HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE	4
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare	4
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare	6
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar	8
4. Treguesit e shërbimit ekspres.....	9

I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesorë të tregut postar për tremujorin e parë të vitit 2019 dhe krahasimet me tremujorin e katërt të vitit 2018 dhe me tremujorin e parë të vitit 2018, i cili publikohet në faqen e Internetit të AKEP www.akep.al, në seksionin “Statistika rreth AKEP”-“Shërbimet Postare”

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e parë të vitit 2019 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (14 subjekte):**
 1. Albanian Cargo Service sh.p.k (A.C.S);
 2. Albanian Courier sh.p.k (A.C);
 3. Albanian Delivery Express sh.p.k (ADEx);
 4. DHL International (Albania) sh.p.k;
 5. RAD MAIL sh.p.k;
 6. Sky Net Logistic sh.p.k;
 7. TNT Express Albania sh.p.k;
 8. Ulysses Enterprises sh.p.k (Fedex);
 9. United Transport sh.p.k (Uni Trans);
 10. Youth Albania Professional Services (YAPS);
 11. Fast-Delivery sh.p.k;
 12. E-KOMPLET sh.p.k;
 13. COEX shpk;
 14. Albanian Parcel Distribution shpk.

Posta Shqiptare me VKD Nr.2581, datë 22.06.2015 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2019 rezultojnë 6,325,421 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të detajuara si më poshtë:

Tabela 1.1- Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara në tremujorin e parë 2019 dhe krahasimi me tremujorin e katërt 2018 dhe me tremujorin e parë 2018.


Shërbime postare të ofruara	T1_2018	T2_2018	T3_2018	T4_2018	T1_2019	Ndryshim T1_2019/ T4_2018	Ndryshim T1_2019/ T1_2018
Posta Shqiptare sh.a							
1 Shërbim Universal Postar							
1.1 Postë brenda vendit	4,398,326	5,057,453	4,596,180	4,246,184	4,821,716	13.6%	10%
1.2 Postë ndërkombëtare	366,173	326,467	486,011	234,923	413,819	76.2%	13%
1.3 Totali 1.1+1.2	4,764,499	5,383,920	5,082,191	4,481,107	5,235,535	16.8%	10%
2 Shërbim joniversal postar							
2.1 Postë brenda vendit	540,222	589,209	793,573	896,597	266,060	-70.3%	-51%
2.2 Postë ndërkombëtare	445	300	224	472	262	-44.5%	-41%
2.3 Totali 2.1+2.2	540,667	589,509	793,797	897,069	266,322	-70.3%	-51%
3 Shërbim ekspres							
3.1 Ekspres brenda vendit	163,968	170,829	187,313	177,621	175,231	-1.3%	7%
3.2 Ekspres ndërkombëtar	4,611	5,068	3,729	5,434	6,400	17.8%	39%
3.3 Totali 3.1+3.2	168,579	175,897	191,042	183,055	181,631	-0.8%	8%
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare							
4 Shërbim JoUniversal Postar							
4.1 Postë brenda vendit	118,115	124,881	130,202	117,747	147,651	25.4%	25.0%
4.2 Postë ndërkombëtare	143,846	166,819	9,714	8,653	10,702	23.7%	-92.6%
4.3 Totali 4.1+4.2	261,961	291,700	139,916	126,400	158,353	25.3%	-39.6%
5 Shërbim ekspres							
5.1 Ekspres brenda vendit	188,075	193,025	377,011	414,844	424,681	2.4%	125.8%
5.2 Ekspres ndërkombëtar	45,470	52,887	55,381	61,763	58,899	-4.6%	29.5%
5.3 Totali 5.1+5.2	233,545	245,912	432,392	476,607	483,580	1.5%	107.1%
6 Totali 1.3+2.3+3.3+4.3+5.3	5,969,251	6,686,938	6,639,338	6,164,238	6,325,421	2.6%	6.0%

Tabela 1.2: Totali i objekteve postare (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare) T1 2019

	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	5,683,488	90%
<i>Of. e tjerë</i>	641,933	10%
Totali	6,325,421	100%

Për sa rezulton nga të dhënat e reflektuara në tabelën 1.2 sa më sipër, për tremujorin e parë të vitit 2019 Posta Shqiptare zë rreth **90%** të tregut postar përkundrejt Ofruesve të tjerë të shërbimeve postare të cilët së bashku zënë **10%**.

Grafiku 1.1: Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujorë




Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, Posta Shqiptare në tremujorin e parë 2019 ka realizuar 5,683,488 shërbime postare, shifër e cila përkthehet në 122,257 objekte postare më shumë se tremujori i katërt 2018, sikundër ofruesit e shërbimeve postare në tremujorin e katërt 2018 kanë realizuar 38,926 objekte postare më shumë se në tremujorin e katërt të vitit 2018.

Tabela 1.3: Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T1-2019

Sh.U	Sh. jo universal	Sh.ekspres	Totali
5,235,535	424,675	665,211	6,325,421
82.8%	6.7%	10.5%	100%

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me rreth 82.8% ose 5,235,535 objekte postare, ndjekur nga shërbimi jo universal me rreth 6.7% ose 424,675 objekte postare. Shërbimi ekspres zë 10.5% ose 665,211 objekte postare.

Grafiku 1.2 Ecuria në 3-mujorë sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet qartë që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar, i cili luhet në nivelet rreth 83% për tremujorin e parë të vitit 2019. Nga krahasimi i periudhës T1-2019 me periudhën T4-2018, vërehet një rritje e numrit të shërbimeve postare në masën 161,183 shërbime, sikundër nga krahasimi i tremujorit të parë të vitit 2018 me tremujorin e parë të vitit 2018 vërehet një rritje e shërbimeve postare në masën rreth 356,170 shërbime.


2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

Tabela 1.4: Shërbimi Universal Postar T1-2019

Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	4,821,716
Postë ndërkombëtare	413,819
Totali	5,235,535

Nga të dhënat e tabelës 1.4 vihet re se gjatë tremujorit të parë 2019, për sa i përket shërbimit Universal Postar, Posta Shqiptare realizoi gjithsej 5,235,535 objekte, nga të cilat Postë brenda vendit 4,821,716 ose 92%, dhe Postë ndërkombëtare 413,819 objekte, ose 8%. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 4,082,272 shërbime për objekte të thjeshta dhe 739,444 shërbime për Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 62,200 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 351,619 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 1.3: Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 mujë



3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare


Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:

Tabela 1.5: Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Shqiptare

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
<i>Shërbim universal postar</i>	5,235,535	92%
<i>Shërbim jo universal postar</i>	266,322	5%
<i>Shërbim ekspres</i>	181,631	3%

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 5,235,535 objekte postare ose 92%, i ndjekur nga shërbimi jo universal me 266,322 objekte postare ose 5%, dhe shërbimi ekspres me 181,631 objekte postare ose 3%.

Grafiku 1.4: Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujorë



Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare gjatë 3-mujorëve të vitit 2018 dhe 3-mujorit të parë të vitit 2019, nga ku vihet re një rënie e ndjeshme në numrin e objekteve postare për shërbimin jo universal dhe një rritje e ndjeshme për shërbimin universal e krahasuar kjo me tremujorin e katërt të vitit 2018.

4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

Tabela 1.6: Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
<i>P.Sh</i>	266,322	63%
<i>Of. e tjerë</i>	158,353	37%
<i>Totali</i>	424,675	100%

Nga të dhënat e raportuara rezulton se për sa i përket shërbimit jo universal postar, treguesit më të mirë i ka Posta Shqiptare me 266,322 objekte postare ose 63% të tregut, kundrejt ofruesve të tjerë me 158,353 objekte postare ose 37%.

Grafiku 1.5: Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujorë



Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në tremujorin e parë 2019 krahasuar me tremujorin e katërt 2018 janë ulur për Postën Shqiptare me 630,747objekte, ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare janë rritur me 31,953 objekte. Nga krahasimi mbi bazën e periudhave tremujore, konstatohet rënie e pjesëve të tregut të Postës Shqiptare për këtë shërbim, ku nga rreth 67% që zinte në tremujorin e parë të vitit 2018, pjesa e tregut të Postës Shqiptare për këtë tregues ka arritur në rreth 63%.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare gjatë tremujorit të parë të vitit 2019 përbëhej nga 413,711objekte brenda vendit dhe 10,964 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.


5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë

Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të parë të vitit 2019, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2018, mbi baza tremujore.

Tabela 1.7: Shërbimi ekspres (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare) për tremujorin e parë 2019.

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
<i>P.Shqiptare</i>	<i>181,631</i>	<i>27%</i>
<i>Of. e tjerë</i>	<i>483,580</i>	<i>73%</i>
<i>Totali T1-2019</i>	<i>665,211</i>	<i>100%</i>

Grafik 1.6: Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria ne 3-mujore



Siç vihet re, për sa i përket shërbimit ekspres, gjatë tremujorit të parë të vitit 2019 ka pasur rritje të shërbimeve postare ekspres e krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit 2018, sikundër vërehet rritje në shërbimet postare ekspres për tremujorin e parë të vitit 2019 e krahasuar kjo me tremujorin paraardhës (T4–2018). Gjithashtu, për shërbimin ekspres vërehet një rënie e pjesëve të tregut për postën Shqiptare, ku nga rreth 42% të tregut për këtë tregues në tremujorin e parë të vitit 2018, pjesa e tregut të postës shqiptare në tremujorin e parë të vitit 2019 ka arritur në rreth 27%, përkundrajt rreth 73% të ofruesve të tjerë.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë së bashku është në vlerat 599,912 objekte postare ose 90%, dhe shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 65,299 objekte postare ose 10%.

Përsa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri paraqitet në vlerën 43,932 objekte postare, shifër kjo dukshëm më e madhe se sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit në vlerë 21,367objekte.